Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". **Nr. 1. Maj 2006** Çmimi: 30 lekë

Si funksionon shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë"

Shoqata e intelektualëve dibranë, lindi si një dëshirë e natyrshme e akumuluar pas një sërë aktivitetesh të kryera nga tubimi i disa intelektualëve dhe biznesmenëve dibranë në promovime librash me karakter historik,letrar dhe studimor.

Këto intelektualë, kanë mbajtur prej një viti ndezur dëshirën për të promovuar vlerat kuturore hisorike dhe letrare të Dibrës dhe dibranëve. Intelektualët dibranë ndjenë nevojën e krijimit të një shoqate për të institucionalizuar dhe formalizuar aktivitete me vlera kulturore, historike ,shoqërore dhe kombëtare që do të bëjnë të mundur një integrim më të mirë të dibranëve në kryeqytet ,duke promovuar identitetin kulturor të trevës së Dibrës.

Pas anëtarësimit të intelektualit dibran në shoqatë, ai do të grupohet në departamentin përkatës sipas profilit dhe fushës që ai shkëlqen më shumë si intelektual. Veprimtaritë që do të zhvillohen në këtë shoqatë, inicohen dhe propozohen nga departamentet dhe pastaj miratohen në kryesinë e shoqatës.

Shoqata ka emblemën e saj,vulën, numrin e llogarisë bankare, programin dhe statutin. Organi i shoqatës është gazeta"Rruga e Arbërit". Seminaret, simpoziumet, takimet, bisedat me personalitete të shquara në plan kombëtarë e ndërkombëtarë, veprimtaritë promovuese, spektaklet dhe demostrimet ne sferën e artit dhe kulturës, mbledhje solemne dhe jubilare, e të tjera forma të larmishme dhe spektakolare do të na bëjnë që të ndjehemi pjesë integrale e kulturës në metropolin shqiptar. Kultura, filozofia, dhe talentet e shfaqura në fusha të ndryshme le të jenë mesazhe që dibranët po i japin shoqërisë shqiptare si faktor zhvillimi. Le të jetë ky promovim i programit dhe statutit të shoqatës një ogur i mirë në integrimin e komunitetit dibran në rrjedhat integruese dhe zhvilluese, brenda sistemit të vlerave demokratike.

RRUGA E ARBËRIT – integron jo vetëm Dibrën



Në foto: Në rreth të verdhë, aksi i Rrugës së Arbërit, sipas një posteri fillestar të shoqatës "Nisma Dibrane", 1996.

Nga XHAFER SEITI
Prefekt i Dibrës

Në ëndrrën mbarë dibrane ka kohë që një vend i rëndësishëm zë ndërtimi i Rrugës së Dibrës, quajtur ndryshe Rruga e Arbrit me rëndësi të jashtëzakonshme e të gjithanshme për rajonin e Dibrës e më gjerë.

LEXONI NE FAQEN 3

NË KËTË NUMËR:

PROGRAMI DHE STATUTI I SHOQATËS "LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË"
FAQE 2

Rruga e Arbrit dhe ca të vërteta...
Nga **FARUK KABA** - FAQE 4

Rruga e Arbërit – përmasa kombëtare e munguar
Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 5

Një e vërtetë mes shumë të vërtetash
Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 5

Këngën po i'a lë trashëgim vajzës
Intervistë e Artistes së Merituar **LIRIE RASHA** (Jushi) me gazetarin **ILMI DERVISHI** - FAQE 6

Zbulohen varret e betejës së Sfetigradit
FAQE 7

Rruga Milot-Peshkopi, rruga e ferrit
FAQE 7

Botime të autorëve dibranë
FAQE 6,8

UDHË E MBARË "RRUGA E ARBËRIT"

Doli edhe një gazetë e re në tregun mediatik shqiptar,një gazetë krejt ndryshe nga të tjerat. Gazeta "Rruga e Arbërit", është organ i Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, e cila do të shërbejë si një mjet mediatik, ku do të lulëzojnë mëndimi dhe aftësitë e itelektualëve që po kontribuojnë në fusha të ndryshme, që nga biznesi i ndërtimit dhe ai tregtar, e deri në fusha më speciale të jetës shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike. Shoqata nuk është politike. Ajo përshkohet nga fryma humane që ka si mision zhvillimin dhe emancipimin e më tejshëm të komunitetit dibran drejt vlerave të përbashkëta europianizuese. Filozofia e gazetës do të jetë bashkëpunimi pa komplekse midis njëritjetrit, duke u ndarë për nga bindjet politike por duke u bashkuar në vlerat tona historike, etnike, kulturore dhe shpirtërore. Gazeta është e hapur për të gjitha penat që do të kontribuojnë në pasurimin e mendimit estetik, filozofik, shkencor e kulturor të realitetit dibran.

PROGRAMI I SHOQATËS "LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË"

Sot më datën 28.03.2005, me vullnetin e lirë të antarëve, miratohet ky Program si ma poshtë vijon:

- Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së shoqatës.Shoqata do të ketë qëllimin e saj si ma poshtë vijon:

- Objekti i veprimtarisë së shoqatës do të jetë:

- Synon të afrojë, të integrojë dhe të nxisë vlerat e intelektualëve dibranë.

- Do të realizojë një bashkëpunim serioz, të organizuar dhe gjithpërfshirës të vlerave intelektuale duke funksionuar brenda një formacioni të institucionalizuar me përgjegjësinë për të organizuar veprimtari që nxisin dhe promovojnë mendimin, vlerat dhe veprat e intelektualëve dibranë me shfaqjet më të spikatura, në fusha të ndryshme të jetës.

- Të kontriubojë në studimin, evidentimin, njohjen dhe përhapjen tek komuniteti dibranë dhe më gjërë të historisë së Dibrës, të zakoneve, traditave e në përgjithsi të të gjitha vlerave shoqërore, positive të arritura nga brezat e mëparshëm.

- Të nxis komunitetin dibranë për të cuar më tej traditën e mirë arsimdashëse, të mbështesë veprimtaritë shoqërore e shtetërore që synojnë në përmirsimin e infrastrukturës së arsimit, pjesmarrjen e fëmijve në shkollë, vlersimin dhe ndihmën ndaj talenteve të reja Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti ajo do të organizojë edhe programe të përbashkëta me shoqatat e tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e saj, si dhe do të mbaj lidhje me institucione që i përshtaten objektit të saj.Aftësimi dhe aktivizimi i shoqërisë mbi bazën e solidaritetit njerzor dhe interesave individduale të shprehura në klimën e një bashkëjetese aktive. Karakteri thellësisht humanitar e edukativ i shoqatës i jep asaj legjitimitetin e ekzistencës afatgjatë dhe të shtrirjes së pakufizuar në të gjitha shtresat e popullsisë.Në stadin aktual shoqata nuk ka kapital fillestar por ajo do të financohet prej kuotave të antarëve të saj, të ardhurat nga organizimi i aktiviteteve të ndryshme si dhe ajo do të sensibilizojë të gjitha fondacionet e vendit dhe të huaja për krijimin e fondeve të saj. Shoqata do të ndihmojë në zhvillimin e demokracisë dhe humanizmin e marrëdhënjeve njerzore.

Antarët themelues
Nuri Abdiu, Hajri Mandrri, Musa Riçku, Shaqir Skarra, Sali Shira

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Rakip Suli, Kryetar
Hajri Mandri
Shaqir Skarra
Halil Rama
Bujar Karoshi
Dukagjin Hata
Mina Hysa
Hasan Leka

ADRESA E GAZETËS:
Blloku i banesave "Gintash" Laprakë
Tel.0683119232

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001
Euro 13-661344-0102
USD 13-661344-0203

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Tel.0683119232. Email: lid_gazeta@yahoo.com

STATUTI I SHOQATËS "LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË"

Në mbështetje të ligjit 7580, datë 29. 07. 1994 nenet 39-53, si dhe ligjit 8781, datë 03. 05. 2002 dhe ligjit 8788. datë 7. 05. 2002 hartohet ky statut i Shoqatës "Lidhja e intelektualëve dibranë"Kjo shoqatë është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të antarëve të saj pa asnjë qëllim fitimi, joqeveritare dhe e pavarur.

NENI 1
EMËRTIMI SHOQATËS.

Emërtimi i Shoqatës do të jetë "Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë" me qendër në Tiranë Blloku Guintash Laprakë.

NENI 2
QËLLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQATËS.

Shoqata do të ketë objektin si ma poshtë vijon: Objekti i veprimtarisë së shoqatës synon të afrojë, të integrojë dhe të nxisë vlerat e intelektualëve dibranë.

-Do të realizojë një bashkëpunim serioz, të organizuar dhe gjithëpërfshirës të vlerave intelektuale duke funksionuar brenda një formacioni të institucionalizuar me përgjegjsinë për të organizuar veprimtari që nxisin dhe promovojnë mendimin,vlerat dhe veprat e intelektualëve dibranë, me shfaqjet më të spikatura në fusha të ndryshme të jetës

-Të kontribojë në studimin, evidentimin, njohjen dhe përhapjen tek komuniteti dibranë dhe më gjërë të historisë së Dibrës, të zakoneve, traditave e në përgjithsi të gjitha vlerave shoqërore, positive të arritura nga brezat e mëparshëm.

-Të nxisë komunitetin dibranë për të cuar më tej traditën e mirë arsimdashësë, të mbështesë veprimtaritë shoqërore e shtetërore që synojnë në përmirsimin e infrastrukturës së arsimit, pjesmarrjen e fëmijve në shkollë, vlersimin dhe ndihmën ndaj talenteve të reja.

-Të evidentojë dhe të ndërmjetsojë konfliktet dhe mosmarrveshjet midis dibranëve dhe individëve të komuniteteve të tjera në bazë të traditë së mirë të pajtimit dhe mirëkuptimit.

-Të edukojë tek dibranët cilsi të larta të moralit qytetar, si të jetuarit me djersë dhe ndershmëri, me familje të shëndoshë, larg krimit dhe korrupsionit, me respekt për pronën, për rregullat që burojnë nga urbanistika dhe për marrëdhënje të mira me qytetarët e komuniteteve të tjera. Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti Lidhja e intelektualëve dibranë do të organizojë edhe programe të përbashkëta me shoqata të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë. Shoqata nuk do të ndjek qëllime politike apo ekonomike. Ajo është organizatë jofitimprurëse dhe jo qeveritare. Për zhvillimin sa më të mirë të këtij objekti ajo do të organizojë edhe programe të përbashkëta me shoqatat e tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë saj, si dhe do të mbajë lidhje me institucione që i përshtaten objektit të saj.

NENI 3
QENDRA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Qendra e Shoqatës do të jetë në Tiranë Blloku Gintash Laprakë Veprimtaria e saj do të shtrihet në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë duke hapur degë në rrethe, qytete e komuna si dhe në shtete të tjera duke siguruar numrin e antarëve të saj

NENI 4
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës 'Lidhja e intelektualëve dibranë është i pakufizuar.

NENI 5
KUSHTET E PRANIMIT DHE LARGIMIT TË ANTARËVE.

Në shoqatë ka të drejtë të antarsohet cdo kush që pranon programin dhe statutin e shoqatës dhe paguan kuotën e caktuar. E drejta për të dhënë dorheqjen i garantohet cdo antari por me kusht që ai të paraqesë një kërkesë së paku një muaj para largimit.

NENI 6

E drejta e antarsimit në shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë të trashëgimie. Antarët që kanë dhënë dorheqjen ose janë përjashtuar nga shoqata nuk kanë të drejtë në kapitalin apo pasurinë themelore të shoqatës.

NENI 7
TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANTARIT.

Cdo antar ka të drejtë të shfaqë mendimet e tij, të diskutojë në mbledhje, të kërkojë llogari për harxhimin e fondeve, të kundërshtojë në Gjykatën kompetente vendimet e shoqatës që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe statutin brenda një muaji nga dita që ka marrë njoftimin për atë vendim. Gjithashtu cdo antar ka për detyrë të zbatojë me rigorozitet dispozitat,ligjin dhe statutin e shoqatës si dhe të derdhë kuotat një herë në vit në datën e caktuar.

NENI 8
ORGANET DREJTUESE, MËNYRA E FORMIMIT DHE KOMPETENCAT E TYRE

Organi më i lartë i shoqatës është Mbledhja e përgjithshme e antarëve të shoqatës. Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e antarëve. Miraton programin vjetor të aktiviteteve që do të realizojë shoqata. Mbledhja e përgjithshme zgjedh ose shkarkon këshillin drejtues me votim të fshehtë. Të gjithë antarët e shoqatës kanë të drejtë vote të barabartë në mbledhjen e përgjithshme. Vendimet merren me shumicën e votave të antarëve që janë të pranishëm në mbledhje.

NENI 9

Këshilli drejtues i shoqatës zgjidhet në çdo dy vjet me votim të fshehtë nga mbledhja e përgjithshme. Këshilli drejtues zgjedh Kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe kordinatorin e shoqatës. Mbledhjet e këshillit janë të rregullta kur janë të gjithë antarët dhe marrin pjesë në të gjysma e tyre. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të pranishme në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta ajo e kryetarit të shoqatës konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve.

Këshilli drejtues i shoqatë ka këto kompetenca:

-Pregadit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe ia paraqet për miratim mbledhjes së përgjithshme.

-Aprovon raportin vjetor të realizimit të detyrave të shoqatës.

-Cakton mënyrën e realizimit të të ardhurave të shoqatës.

-Vendos për ndryshimet që duhen bërë në rregullimet e shoqatës.

-Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga organe dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi e ndihmë e ndërsjelltë.

-Diskuton cdo gjë të jashëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhgjes dhe merr vendime rreth tij.

-Punësimin e personave në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

(Vijon në faqen 5)

RRUGA E ARBËRIT – INTEGRON JO VETËM DIBRËN

(Vijon nga faqja 1)

PAK HISTORI:

Historia e Rrugës së Arbrit është shumë e lashtë, që nga periudha romake. Ajonë shekuj është rrahur nga karvanët. Ka qenë rruga më e shkurtër që lidhte Dibrën me Tiranën dhe është përdorur deri vonë, si më e leverdisshmja e krahasuar me atë që kalonte nga Qafë-Murra.

Pas çlirimit u ndërtua rruga Tiranë-Milot-Burrel-Klos-Bulqizë-Peshkopi, e cila shfrytëzohet sot, me gjatë 183 km, e shkatërruar plotësisht nga Miloti në Peshkopi.

Më 4 janar të vitit 1996, një grup intelektualësh në shoqatën "Nisma Dibrane", me kryetar zotin Iliaz Kaca, me njëletër me 46 firma iu drejtuan Presidentit të Republikës, zotit Sali Berisha, Kryeministrit Aleksandër Meksit, ministrit të Mbrojtjes Safet Zhulali, deputetëve të Dibrës, prefektit, Institutit të Studimeve e Projektimeve, forcave politike në rreth, me të cilin sensibilizohen domosdoshmërinë dhe avantazhet e gjithanshme të ndërtimit me parametra modernë të Rrugës së Arbrit.

Kjo letër e parë bëri shumë përshtypje në opinion, shkroi shtypi, u bë objekt i radios dhe televizionit.

Më 14 tetor 1996, Këshilli i Ministrave vendosi të ngrihet grupi i punës për studimin e rrugës, por një e tillë nuk u realizua, për shkak të rrjedhjes që morën ngjarjet, të cilat tashmë dihen.

Kërkesat e shoqatës "Nisma Dibrane", por dhe të organeve të qeverisjes vendore të të dyja niveleve, të deputetëe, të institucionit të prefektit, vazhduan në vijimësi deri në vitin 2003, kur qeveria u bind për nevojën e ndërtimit të kësaj rruge dhe akordoi fondin prej 11 milionë lekësh për studimin e fizibiletit.

Sensibilizim i opinionit është bërë me takime të mirorganizuara brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Në nëntor të vitit 2003, ky studim u përfundua nga studio "ITP-INFRA TRANS Projekt LTD" me drejtor dr. Faruk Kaba, kryetar i grupit të studimit.

Sipas studimit, varianti më i leverdisshëm doli ai, sipas aksit të Rrugës së vjetër të Arbrit (varianti i dytë nga tri variante të studiuara), që fillon në Tiranë – Ura e Brarit – Shupal – Murrizë (tunel) – Guri i Bardhë (tunel) Ura e Vashës – Qafë e Buallit (tunel) – Bulqizë – Shupenzë – Gjoricë (kufi) e barabartë me 72,6 km.

Raporti paraprak teknik i këtij studimi është shtjelluar më 12 tetor 2003, në ngazetën "Korrieri" dhe sqarime të hollësishme jep profesor, doktor Bashkim Lleshi në një shkrim të gazetës "Dibra", nr. 68, të muajit prill 2004.

Kjo rrugë e ka aksin e saj, ka resurset e veta ndërtuese, është zgjedhur para shumë shekujsh nga vetë populli dhe ndoshta ka ardhur koha t'i shërbejë këtij populli, tanimë e ndërtuar me parametra evropianë e modernë.

ARGUMENTE:

Natyrisht që studimi i fizibilitetit ka përcaktuar përparësinë e ndërtimit të kësaj rruge, por më lejoni të parashtroj disa prej mendimeve të thithura nga specialistë dibranë, organet e qeverisjes vendore dhe nga shoqata "Nisma Dibrane". Ndërtimi i kësaj rruge ka rëndësi të jashtëzakonshme ekonomike, kulturore e kombëtare për Qarkun e Dibrës dhe më tej i hapet drita jeshile për integrim mbarëkombëtar dhe prosperitetit të gjithanshëm.



Në foto: Ura e Vashës, një nga urat e aksit të rrugës së vjetër. Këtu do të kalojë edhe Rruga e Re e Arbërit. Fotografia është e stafit të punës që është marrë me studimin e fizibilitetit të rrugës.

Ndërtimi i kësaj rruge do ta nxirrte Dibrën nga izolimi i sotëm e konsiderimi si "një xhep" anësor i Shqipërisë.

Ndërtimi i kësaj rruge u shërben qyteteve apo rretheve: Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Elbasan, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Mirditë, Shkodër, Tiranë me një popullsi rreth 1 milion e 750 mijë banorë brenda republikës së Shqipërisë, në Kosovë, Maqedoni, Turqi, Bullgari, Rumani etj. Vetëm në Qarkun e Dibrës (Dibër, Bulqizë e Mat) përfitojnë rreth 200 mijë banorë, rreth 400 mijë mshqiptarë në Maqedoninë Perëndimore, përfiton i gjithë Ballkani Qëndror.



*Në foto: **Pjesë nga aksi aktual i Rrugës së Arbërit.** Foto: B.K.*

Ndërtimi i kësaj rruge "i heq nga shpina" Dibrës 83 km rrugë të tepërt, të cilën e ka pasur "barrë" për mbi 50 vjet. Qytetet Burrel e Bulqizë kthehen në lagje të Tiranës, me largësi nga qendra e saj respektivisht 52 dhe 51 km (nga 98 km dhe 131 km që janë sot), largësia Peshkopi – Tiranë mbetet vetëm 100 km, Dibra e Madhe mbetet larg Tiranës vetëm 83 km nga 162 që është sot, Gostivari 141 km, nga 228 km që është sot apo 242 km që duhet të bëjë nga Qafë-Thana.

Me ndërtimin e kësaj rruge, shteti shqiptar vihet në zotërim të plotë të luginës së Drinit të Zi, lugina më e madhe dhe e rëndësishme e Shqipërisë Qëndrore, ku janë të përqëndruara resurse të mëdha kromi (300 milion ton) mermeri, gipsi, ujërat termale etj.

Rrit shkëmbimin ekonomik e kulturor, qarkullimin e njerëzve, shkëmbimin e mallrave brenda dhe jashtë vendit.

Dibra afrohet me Tiranën e gjithë Shqipërisë, lëvizja drejt kryeqytetit nuk është më një tmerr ekonomik e shëndetësor (12 orë udhëtim vajtje-ardhje për në Tiranë me furgon në rrugën ekzistuese jashtë çdo lloj standarti, sëmurin dhe njeriun e shëndoshë), kursehet koha dhe ulet vlera e biletës së udhëtimit, mirëmbahen automjetet, konsumohen goma dhe karburant, gjëra të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në nivelin ekonomik të të gjitha shtresave të popullsisë, edhe të atyre që kanë mundësi të lëvizin me mjetet e veta dhe të atyre që janë të detyruara ekonomikisht të lëvizin drejt Tiranës me mjete taksi.

Ndikimi pozitiv në zhvillimin e biznesit është në përmasa të pallogaritshme. Ndërtimi i kësaj rruge do të ndalojë migrimin e pakontrolluar të pamotivuar e të pavend të qytetarëve dibranë, bulqizakë e matjanë, drejt qyteteve të tjera. Është faktor i rëndësiëshëm për rritjen e investimeve të huaja e të brendëshme, si dhe për zhvillimin e turizmit, për të cilin resurset në Qarkun e Dibrës janë të mrekullueshme. Me ndërtimin e kësaj rruge, Dibra nuk zvarritet më drejt progresit, por e ardhmja fluturon vetë drejt saj. Koha e përllogaritur e mbulimit të shpenzimeve për këtë rrugë është shumë e shkurtër.

Nisur nga këto arsye e të tjera, Organi Këshillues i Prefektit, në mbledhjen e muajit dhjetor 2005, rekomandoi për prefektin si prioritet të parë për Qarkun e Dibrës: Ndërtimin e Rrugës së Arbrit dhe unë i bindur për domosdoshmërinë e ndërtimit të kësaj rruge, me shkresë të veçantë argumentuese e kam përcjellë këtë rekomandim në Këshillin e Ministritë përkatëse, duke e renditur në vendin e parë të prioriteteve, gjithashtu u jam drejtuar 14 deputetëve që kanë lidhje me Dibrën për të bërë lobingun e tyre, në dobi të ndërtimit të kësaj rruge. Kam ftuar qeverinë shqiptare të kosniderojmë mundësinë e fillimit të punës në këtë projekt të madh e shpëtimtar për rajonin, për të realizuar një ëndërr për këtë popull me probleme të shumta ekonomike.

XHAFER SEITI

Rruga e Arbrit dhe ca të vërteta...

Nga **FARUK KABA**



Në foto: ***Nga një ekspeditë e anëtarëve të shoqatës homologe "Nisma Dibrane" në aksin e vjetër të rrugës së Arbërit. Falë anëtarëve të kësaj shoqate problemi i Rrugës së Arbërit mori përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare.*** *Foto: B.K.*

I dashur Alfred!

Siç biseduam në telefon, më poshtë po ju rendis në mënyrë kronologjike, si kanë rrjedhur ngjarjet lidhur me Rrugën e Arbrit. Siç ta thashë mora shkas nga shkrimi në gazetën "Shqip" i datës 13 maj i kryetarit të Qarkut të Dibrës, z.Xhafer Seiti, me titull "Rruga e Arbrit dhe integrimi". Dua t'ju them që në fillim, se shkrimi është shumë i mirë si në përmbajtje ashtu dhe në qëllimin dhe synimin e tij. Nëse mund ta quaj kështu, ai është një shkrim i sinqertë, por… megjithatë, u bë shkas i këtij reagimi. Nuk e kuptoj se ç'është kjo ndjenjë e jona (e shqiptarëve) për "lavdi", për t'i atribuar vetes merita nganjëherë jo vetëm të paqena, por edhe absurde në kuptimin që, kur jep një kontribut për një çështje përse duhet të rrahësh gjoksin me merita apo pa meritë. Rruga e quajtur e Arbrit, është një objekt për të cilin sa më shumë të shkruhet aq më mirë i shërben çështjes së realizimit të saj. Megjithëse po merr udhë, ajo akoma mbetet një çështje debatesh dhe diskutimesh, por kur me këto shkrime fillojnë e "ngatërrohen" edhe "merita" dhe shtrembërohen fakte (në këtë rast jam i sigurt që nuk bëhet me qëllim, por ndoshta nga mosnjohja e fakteve) atëherë ato sikur e ndotin paksa atë mjedis të pastër nga ai buron.

E kam fjalën dhe i referohem gjithnjë shkrimit të zotit Xhafer Seiti, kryetar i nderuar i Qarkut të Dibrës. Në shkrimin e tij thuhet se: "…më 4 janar të vitit 1996, një grup intelektualësh dibranë, të inkuadruar ë shoqatën "Nisma Dibrane", me kryetar zotin Iliaz Kaca, me një letër me 46 firma iu drejtuan Presidentit të Republikës, zotit Sali Berisha, kryeministrit Aleksandër Meksi, ministrit të Mbrojtjes, zotit Safet Zhulali, deputetëve të Dibrës, prefektit, Institutit të Studimeve e Projektimeve, forcave politike në rreth, me të cilin sensibilizonin domosdoshmërinë dhe avantazhet e gjithanshme të ndërtimit me parametra modernë të "Rrugës së Arbrit". Deri këtu çdo gjë duket në rregull. Më tej, artikullo vazhdon: "…Me 14 tetor 1996, Këshilli i Ministrave vendosi të ngrihet grupi i punës për studimin e rrugës, por një gjë e tillë nuk u realizua, për shkak të rrjedhës që morën ngjarjet, të cilat tashmë dihen"… dhe pak më poshtë: "Në nëntor të vitit 2003, ky studim u përfundua nga studio "ITP – Infratransprojekt" me drejtor dr.Faruk Kaba, kryetar i grupit të studimit, etj., etj…"

Ajo që dua të them, i dashur Alfred, është se e vërteta nuk është pikërisht e ekzaktësisht kështu, por diçka më ndryshe. Ideja për të "nxjerrë" apo "marrë" lavdinë për autorësinë e një rruge, (ndoshta edhe të ndonjë projekti apo edhe të një nisme) po kthehet në mani. Sa për rastin konkret të Rrugës së Arbrit apo të një korridori apo arteri tjetër çfarëdo, dua t'ju them, se ato nuk mund të bëhen nga kushdo, qofshin intelektualë apo jo. Ato bëhen vetëm nga profesionistë dhe madje, jo nga cilido profesionist, por nga ata më me eksperiencë, pasi nuk janë emiprizma apo hamendje, por janë pjesë e përvojës më të mirë të teknikës dhe shkencës së fushës përkatëde. Për rastin konkret dua t'ju them se rreth vitit 1988, kur punoja pranë Intitutit të Transportit, fillova me një iniciativë personale të studioja një master-plan të rrugëve të Shqipërisë. Vazhdimisht më kishte ngacmuar kjo ide (dhe sot e kësaj dite shteti shqiptar nuk posedon një të tillë dhe është për të ardhur me të vërtetë keq). Puna kishte filluar me studimin e korridorit veri-jug apo ndryshe Hani i Hotit – Kakavijë, i cili u realizua (po në këtë vit). Studimi i master-planit të rrugëve të të gjithë vendit, ishte sigurisht, një sipërmarrje dhe një sfidë e jashtëzakonshme, por jo e papërballueshme. Duke punuar dhe menduar për këtë, (sigurisht, jashtë të gjitha detyrimeve shtetërore dhe pa asnjë shpërblim) hodha piketat e para të akseve rrugore më të rëndësishme të Shqipërisë: Korridori Hani i Hotit – Kakavijë, aksi Durrës – (Kukës) Motinë, për lidhjen me Kosovën (është pikërisht ai që do të realizohet tani pas kaq vjetësh), si dhe dy akse: ai Tiranë-Dibër (emri Rruga e Arbrit iu vu më vonë dhe për të qenë i sinqertë nuk e di nga kush dhe në çfarë rrethanash) dhe ai Durrës-Rrogozhinë-Kuçovë-Gramsh-Maliç-Kapshticë, si dhe disa rrugë të tjera, të cilat do t'i përmend më poshtë.

Ç'ishin këto dy akse Tiranë - Dibër dhe Durrës – Kuçovë – Gramsh - Kapshticë? Atëherë sapo kishte filluar të flitej për një rrugë që do të lidhte Shqipërinë me pjesën tjetër të Ballkanit: rruga Durrës – Elbasan – Qafë-Thanë. Nuk i mbaj mend me ekzaktësi, por në Tiranë ishte mbajtur një konferencë, nëse nuk gaboj e ministrave të Jashtëm të Ballkanit, ku ishte diksutuar edhe për rrugët dhe lidhjen e vendeve të rajonit ndërmjet tyre mbi bazën e një fryme të re bashkëpunimi eth., etj. Mesa duket po afronte koha e ndryshimeve. Kaq fort iu mëshua në atë kojë idesë së kësaj rruge, pra Durrës – Elbasan – Qafë-Thanë dhe më tej Shkup-Sofje-Stamboll, saqë ajo u bë si temë bisedash jo vetëm ndër specialistë, por edhe më gjerë. Duke e parë me sy tjetër, në vend të këtij Korridori, që më vonë u quajt dhe Korridori i Tetë, unë mendova (dhe këtë e hodha në harta), një "dyfishim" apo ndryshim të tij. Pasi studiova me kujdes në harta, punë që e kisha filluar me master-planin e rrugëve, ideja ishte që në vend të Durrës – Elbasan – Qafë-Thanë të realizoheshin dy akse të reja: rruga Durrës-Tiranë-Dibër, e cila arrinte Shkupin me rreth 100 km më pak se koridori që propozohej nga Qafë-Thana dhe rruga tjetër Durrës – Rrogozhinë – Kuçovë – Gramsh – Maliq – Kapshticë. Në këtë mënyrë, lugina e Shkumbinit, e cila kishte një infrastrukturë të ngarkuar (hekurudhën dhe një rrugë relativisht të mirë), s'kishte pse të kishte dhe një autostradë, në një kohë që dy rajonë tepër të varfra apo gati fare painfrastrukturë rivlerësoheshin katërcipërisht. Jo vetëm kaq, por në destinacione finale arrihej shumë më shpejt: nga dibra në Shkup e Sofje dhe nga Kuçova, Gramshi e Kapshtica në Selanik e Stamboll. Edhe Shqipëria fitonte më shumë në këtë mënyrë.

Në vitin 1990 dhe 1991, duke vazhduar me ëndrrën e master-planit dhe idenë e përgjithëshme të korridoreve kryesore të vendit, studiova në detaje Rrugën e Arbrit apo të Dibrës. Për të qenë i saktë, e mendoja atë me një tunnel 11 km të gjatë (çdo gjë u trasua në harta) dhe me një nënvariant me tunel 9 km që rrushkullonte formacionet pranë Urës së Vashës. Sipas këtyre zgjidhjeve, rruga nga Durrësi (buza e ujit) deri në kufirin shtetëror, bëhej ekzakt 100 km, ndërsa nga Tirana, 65 km (në vend të 72.6 km të projektit të tanishëm). Sipas kësaj ideje, rruga dilte pothuaj horizontale dhe pa ngjitje deri në kuotat 850 m siç është parashikuar në projektin actual.

Në vitin 1992, ish-kryeministri Aleksandër Meksi, i nisur edhe nga njohja personale, më kërkoi se ç'ide konkrete kishim ne që punonim me rrugët. Në përgjigje të kërkesës së tij, unë dorëzova pranë Kryeministrisë, të hedhur në një hartë të shkallës 1:200 000, të gjitha akset e studiuara si ai Veri-Jug, rruga Durrës – Morinë, rruga Tiranë – Elbasan (që tani një tjetër inxhininier e quan "zbulim" të tijin), rruga Durrës – Rrogozhinë – Kuçovë – Gramsh – maliq Kapshticë, rruga Lezhë – Shëngjin – Ulqin, të cilat do të duhej të ishin në fokusin e qeverisë demokratike të kohës për ndryshimin e imazhit dhe gjendjes së rrugëve në Shqipëri. Së bashku me të, kryeministrit Meksi iu bënë edhe propozime shumë të rëndësishme për krijimin edhe të një structure të re: një agjencie të pavarur të rrugëve, e cila shumë shpejt pas kësaj u ngrit (Drejtoria e Përgjithëshme e Rrugëve).

Për t'ju kthyer shkrimit shkak për këtë reagim, ideja e një rrjeti rrugor, në formën e një master-plani, u prit mjaft mirë nga zoti Meksi dhe ishte ai që nisi përpjekjet për implementimin e tij dhe fillimin e modernizimit të rrjetit rrugor të Shqipërisë. Në një bisedë me ish-ministrin e Mbrojtjes, Safet Zhulali, (që ishte dhe deputet i zonës së Dibrës) ai i tregoi atij idenë e një rruge që do të lidhte shkurt Tiranën dhe Durrësin me Dibrën dhe të gjithë rajonet e saj. I ndjeri zoti Zhulali, organizoi intelektualët e Dibrës ku ai kishte origjinën dhe lidhjet e tij dhe këtu vazhdon historia siç e përshkruan i nderuari zoti prefekt i Dibrës në shkrimin e tij.

Për ta çuar deri në fund të vërtetën dhe historinë dhe për të freskuar dhe një herë kujtesën e ndriçuar edhe në shkrimin në fjalë, vazhdoj edhe me disa detaje të tjera: Edhe pas 1997-ës intelektualët dibranë, që unë i çmoj e i respektoj së bashku me drejtuesit në qark, vazhduan t'i drejtohen qeverisë dhe Ministrisë së Transportit me kërkesën për Rrugën e Arbrit, por meqë ndër drejtuesit e asokohe nuk kishte askush njohuri për këtë rrugë (kam parë edhe një letër të kryetarit të Qarkut të Dibrës dërguar një ish-ministri) përgjigja ose nuk jepej ose mbetej e turbullt. Në vitin 2001 nëse nuk gaboj, një letër e tillë iu drejtua edhe ish ministrit të ri të Transportit, i cili duke qenë vetëm specialist rrugësh e adresoi tek unë për mendim (si konsulent privat me eksperiencë në këtë fushë). Sigurisht që unë shpjegova të gjitha detajet dhe atë që përfaqësonte ky projekt. Më pas, Ministria e Transportit mori vendimin për studimin e fizibilitetit dhe pas rezultatit pozitiv të tij, vendimin e tij.

Kjo është historia e kësaj rruge, historia e këtij projekti.

E shkruaj këtë letër, pasi në Shqipëri, përveç ndjenjës së lavdisë, ndjenjës pak primitive për të rishkruar historinë, në disa raste po humbet edhe kujtesa, e cila është një nga gjërat e rrezikshme që mund t'i ndodhë një kombi. Sigurisht, nuk është vendi këtu, por në një rast të tjetër do të desha të zbardh edhe fakte të tjera, për të cilat një ditë edhe nëse nuk e bëj unë, pasi e kam pak të rëndë të flas për veten, dikush do t'i nxjerrë në pah.

SHËNIM I REDAKSISË: Ky shkrim është botuar në gazetën "Shqip". Meqë autori është një përkrahës shumë i vyer në këtë proces, redaksia mendoi ta ribotonte shkrimin, duke ftuar njëkohësisht edhe personalitete të tjera të na dërgojnë shkrime lidhur me këtë temë.

RRUGA E ARBËRIT – PËRMASA KOMBËTARE E MUNGUAR

Nga SHAQIR SKARRA

Ditët e fundit është publikuar një tender me vlerë 15 000 000 lekë për ndërtimin e një segmenti të Rrugës së Arbërit nga Ura e Çerencit deri në Kufi (Bllatë, Peshkopi). Tenderi do zhvillohet me 26 qershor 2006. Ky është segmenti i dytë që parashikohet të ndërtohet, pas atij në Fushë Bulqizë.

Në projektet e qeverisë për akset kryesore rrugore që dilnin nga Tirana, edhe Rruga e Arbërit duket se po merr formë. Historia e Rrugës së Arbërit ka filluar pas proceseve shumëpartiake në vend. Ndoshta pushtetarët as që do të kujtoheshin se ekziston dhe një rrugë me emrin e "Arbërit", ku në mesjetë por dhe më vonë ka qenë një ndër arteriet kryesore të vendit në atë periudhë kohe pas "Egnatias". U desh një punë parapregaditore nga intelektualët dibranë të grupuar në shoqatën "Nisma dibrane" të cilët sensebilizuan opinionin shqiptar se ekziston dhe një rrugë me emrin "Rruga e Arbërit". Media elektronike dhe ajo e shkruara kanë qënë gjithmonë pjesë e shqetësimit qytetar për këtë rrugë.

Fill pas shoqatës "Nisma dibrane" edhe pushteti lokal dhe institucioni i prefektit në Dibër filluan ta kërkojnë në strukturat shtetërore si dicka që u takon dibranëve.Tashmë kjo rrugë është vënë në qendër të mediave dhe të gjithë opinionit publik.Historia e rrugës së Arbrit është e lashtë, tepër e lashtë. Ajo zë fill me perandorinë romake dhe itinereari që diskutohet të zbatohet sot në ato vite të hershme është rrahur me karvane dhe këmbësor. Kjo rrugë ka qënë më praktike dhe e shkurtër që lidhte Dibrën me Tiranën dhe është përdorur deri vonë jo vetëm për dibranët por dhe shumë fshatra të Kuksit, Bulqizës e Matit.Kjo shfrytzohej më tepër se rruga tjetër që kalonte nga Qafë Murra. Gjatë viteve të pushtetit diktatorial u ndërtua rruga Tiranë Dibër e cila futej në Burrel duke e aneksuar tërësisht rrugën e Arbërit. Pas viteve nëntëdhjet kur ngjarjet u rrokullisën ndryshe një grup intelektualësh dibranë të grupuar në shoqatën 'Nisma dibrane" pasi e shkelën disa herë vetë këtë rrugë më këmbë më së fundi i dërguan një letër edhe qeverisë shqiptare. Letra e firmosur nga intelektualë dibranë me mbi 65 firma vajti në zyrën e kryeministrit të asaj kohe zotit Aleksandër Meksi në janar të vitit 1996. Fakt është se kjo letër bëri bujë pasi u bë objekt i shtypit dhe televizioneve për herë të parë.

Opinioni i gjërë u njoh edhe me një rrugë që Dibrën e afronte pranë Tiranës duke shkurtuar mbi 110 kilometra nga rruga ekzistuese.Vetë ish kryeministri i asaj kohe zoti Aleksandër Meksi e ka pohuar një fakt të tillë bile dhe e ka mbështetur këtë nismë të dibranëve. Bashkë me këtë grup nismëtar u bashkuan dhe forcat politike në Dibër të cilët filluan të sensibilizojnë opinionin e gjërë për domosdoshmërinë dhe avantazhet e gjithanshme që kishte ndërtimi i rrugës së 'Arbërit". Në vitin 2003, u hap "drita" jeshile, pasi qeveria shqiptare akordoi një fond prej 11 milion lekësh vetëm për studimin e fizibilitetit të gjithë trasesë që do të kalonte rruga. Brenda vitit 2003 ky projekt u përfundua. Drejtor këtij projekti ishte zoti Faruk Kaba. Për ndërtimin e kësaj rruge studimi u bë në tre variante.Nga të tre variantet doli më i përshtashmi ai i rrugës së vjetër të "Arbërit" i cili fillon Tiranë-Ura e Brarit-Shupal-Murrizë (tunel)-Guri i bardhë (tunel)-Ura e Vashës-Plan i Bardhë-Qafa e buallit(tunel)-Shupenzë-Gjoricë. E gjithë kjo trase bashkë me tunelet është gjithsejt 72.6 km. Nga 183 km që është sot rruga ekzistuese dhe e gjitha jashtë parametrave bashkëkohor . Rruga e "Arbërit shkurton afro 110 km rrugë. Megjithse shteti shqiptar ka ndërtuar dhe po vazhdon të ndërtojë rrugë të ndryshme ku i ka dhënë dhe vazhdon t'i jap përparsi infrastrukturës në jug, populli i Dibrës e ka bërë zgjedhjen vetë e jo sot por vite më pare qysh atëherë kur ekzistonte dhe shteti i Arbërit.Themi me bindje se tashmë ka ardhur momenti i duhur se sa pregaditen projekte për akset rrugore të jugut apo autostradën e Elbasanit le t'i hedhin sytë edhe tek rruga e "Arbërit"si pjesë e koridorit veri lindor e cila nuk është efikase vetëm për Dibrën dhe dibranët por shërben për gjithë Ballkanin qendror. Shumë studiues dhe intelektual dibranë hedhin një sërë argumentash bindëse se pse duhet të ndërtohet kjo rrugë.

Themi me bindje të plotë se për nga rëndësia edhe rruga e "Arbërit" nuk është më pak e domosdoshme se rrugët e tjera që po ndërtohen sot tek ne.Dibranët shpresojnë bashkë me matjanët, bulqizakët, kuksianët e gjithë shqiptarët por shpresojnë edhe shqiptarët që banojnë në vise të tjera se është pikërisht kjo rugë që i afron më shumë me kryeqytetin shqiptar. Koridorët e jugut janë të shumtë dhe të njohur për publikun.Koridorët e veriut janë të pakët, shumë të pakët, shpresojmë të mos mbeten të tillë.Kudo në botë veriu ka një zhvillim më të madh se në jug.Në Shqipëri është krejt ndryshe.E kjo vjen si rezultat më shumë i infrastrukturës.Ngaqë është futur në supërprojektet e qeverisë shqiptare le të shpresojmë se një ditë do të hapet megjithmend drita jeshile dhe për rrugën e "Arbërit" aq të përfolur vitet e fundit në media.Ka ardhur momenti që kjo të mos mbetet një ëndërr e bukur e dibranëve por të bëhet një realitet.

Një e vërtetë mes shumë të vërtetash

Nga BUJAR KAROSHI

"Rruga e Arbërit" nuk është tani vetëm një titull gazete. Ky emër është shumë herë më shumë se kaq. Kjo rrugë tani është kthyer në një personifikim të së ardhmes, që gjithsecili prej nesh mundohet të ndërtojë. Por sot, pas 10 vjetësh, ka shumë ndryshim ky emër në mendimin tonë, në krahasim me atë të para 10 viteve, 1995.

Më 8 tetor të vitit 1995, gazetari i radio Tiranës për Dibrën hyn në dhomën e regjistrimit të lajmeve dhe fillon të regjistrojë një kronikë. Kryeredaktores së atëhershme të lajmeve në këtë radio, Zamira Kolecit, i bën shumë përshtypje termi i përdorur në kronikë: "Rruga e Arbërit". - Çështë kjo rrugë - pyeti gazetarin, nga frika se mos po bëhej ndonjë "*lajm i keq*" me këtë kronikë. Dhe gazetari u përgjigj: Nga Sheshi Skënderbej dalin 4 rrugë kryesore: E para quhet Rruga e Elbasanit dhe të çon në Elbasan, e dytë quhet Rruga e Kavajës dhe të çon në Kavajë, e treta quhet Rruga e Durrësit dhe të çon në Durrës, ndërsa e katërta quhet Rruga e Dibrës dhe të çon ... te "Shkolla Skenderbej". Zamira Koleci e miratoi kronikën dhe madje u bë një mbështetëse e fortë e kësaj ideje. Ajo u transmetua në emisionin qendror të lajmeve dhe një ditë më vonë në gjitha edicionet e lajmeve. 24 orë më vonë autori i këtyre rreshtave botoi një nga shkrimet e tij të para në median e shkruar, gazetën "Albania". Brenda javës gazeta "Flaka" në Shkup botoi një shkrim për këtë problem. Gazetarë të saj zbritën në Peshkopi të kërkonin informacione më të hollësishme, por nga zyrat e zyrtarëve nuk kishte asnjë të tillë. I vetmi burim informacioni ishte korrespondenti i Radio Tiranës për Dibrën. Ky quhej Hysen Uka.

Ky gazetar, atë kohë takoi shumë personalitete dibrane dhe jo dibrane, që kishin të bënin drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me Rrugën e Arbërit. Ua paraqiste problemin atyre dhe kërkonte bashkëpunim se si mund të bëhej e mundur sensibilizimi i opinionit dhe Qeverisë për këtë problem. Kishte njerëz që bëheshin optimistë për këtë, dhe kishte të tjerë, një pjesë prej tyre edhe me ndikim në politikë dhe qeverisje, që ishin pesimistë, për të mos thënë e pamundur. Por një herë tjetër do t'i lëmë pengestarët. Këtë radhë po përmendim vetëm ndihmëtarët. E natyrisht, të parët vijnë nga mediat.

Aqif Ademi shkroi një skenar për një dokumentar për këtë punë, por përpjekjet për të gjetur një financim nuk bënë të mundur hartimin e këtij dokumentari. Të tjerë mbështetës të kësaj ideje fillestare të Hysen Ukës u bënë Ali Hoxha, Lavderim Shehu, Hamit Xhaferi, Islam Cani, Defrim Methasani, Neki Iskurti dhe shumë të tjerë, të cilët i kanë të shkruar kontributet e tyre qytetare në historikun e një shoqate që do të merrte udhë në vitin 1998.

Këto përpjekje minimale bënë të mundur që në një mbledhje të Qeverisë "Meksi" të miratohej një plan, ku Rruga e Arbërit ishte një nga 5 rrugët kryesore që Qeveria mendoi të bënte studimin e fizibilitetit. Ndoshta ky vendim ishte fryt i një ndikimi të ish -Ministrit të Mbrojtjes, Safet Zhulali, i cili ishte njëri që e përkrahu këtë ide që erdhi nga media.

Por, ndërsa nga media qarkullonte si ide zhvillimi, organet zyrtare kishin dijeni më shumë për këtë problem. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve ishin shumë optimistë për ndërtimin e saj. Dy specialistë të projektimit e ndërtimit të rrugëve, dibranët Faruk Kaba e Bashkim Lleshi, ishin ndihmëtarët më të mirë të Rrugës së Arbërit.

Përpjekjet për të sensibilizuar Qeverinë vazhduan, por Ali Hoxha dhe një ndihmë shumë të vyer. Në Peshkopi, na tha ai, është një arkeolog shumë i njohur, i cili duhet të ketë njohuri patjetër për këtë rrugë. Ky quhej Iljaz Kaca, i cili ka dhënë padyshim një ndihmesë shumë të vyer për këtë problem. Iljaz Kaca dhe Hysen Uka bënë të mundur që bashkë me 60 qytetarë dibranë të themelonin shoqatën "Nisma Dibrane" në vitin 1998, duke nisur kështu një institucionalizim të këtij procesi, që padyshim i ka dhënë kësaj rruge nisma të reja, të parën, bindjen se sot nuk ka asgjë që pengon integrimin e Dibrës.

Ajo që më bëri të shkruaj këto rreshta është padyshim një e vërtetë që duhet thënë. Duhet thënë, pasi Rruga e Arbërit do të ndërtohet mbi kollona të forta, të qëndrueshme, pasi ajo rrugë do ta bëjë Dibrën kryeqendër të Shqipërisë. Sepse kështu është. Por që të ndërtohet e fortë duhen njohur, padyshim meritat e qytetarëve të saj. Duhen njohur ideatorët fillestarë dhe ata që nënshkruan letrën e 1998-ës drejtuar gjithë institucioneve shqiptare, duhen njohur 65 firmëtarët e Shoqatës "Nisma Dibrane", emrat e të cilëve padyshim do ti botojmë numrat e ardhshëm. Jo vetëm të tyre, por edhe të atyre jodibranëve, të cilët kanë kontribuar shumë që "Rruga e Arbërit" të bëhej e njohur botërisht.

STATUTI I SHOQATËS "LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË"

(Vijon nga faqja 2)

NENI 10

Kryetari i Shoqatës zgjidhet nga këshilli drejtues dhe ka këto kompetenca:

-Administron fondet sipas mënyrës së caktuar nga këshilli drejtues.

-Hyn në marrëdhënje më shoqata të tjera.

-Pregadit dhe thërret mbledhjen e këshillit drejtues.

-Kujdeset për interesat e shoqatës, i mbron ato si dhe përfaqëson shoqatën në marrëdhënje me të tretët.

NENI 11
MJETET FINANCIARE.

Shoqata hap llogarinë e vet pranë bankës. Të ardhurat e shoqatës do të sigurohen si të vendosen mbas mbledhjes së parë të përgjithshme të antarëve. Cdo antar i shoqatës do të paguaj kuaticionin e tij cdo gjashtë mujor në shumën 1000 lek të reja. Gjithashtu burim financimi shoqata do të ketë financim edhe nga shoqëritë dhe donator vendas dhe të huaj si nga K. E. OFADA, Unioni Evropian dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Buxheti i shoqatës do të do të konsistojë edhe nga dhuratat dhe ndihmat, programet e financuara nga Organizata Ndërkombëtare, fondacionet e huaja e nacioanale, bordet ndërkombëtare, kombëtare rajonale dhe lokale. Në këtë rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të përpilohet dokumentacioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 12
MËNYRA E NDRYSHIMIT TË STATUTIT.

Statuti ndryshohet vetëm me vendim të mbledhjes së përgjithshme kur në të marrin pjesë shumica e antarëve. Ndryshimet në statutut do të bëhen në rast se nuk përmbushet ndonjë nga objektivat e parashtruara në nenin 2 të këtij statuti.

NENI 13
MËNYRA E SHPËRNDARJES TË SHOQATËS.

Shoqata shpërndahet me vendim të mbledhjes së përgjithshme të thirrur nga Këshilli drejtues. Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 12 të këtij statuti. Shoqata shpërndahet në këto raste:

-Kur numri i antarëve është nën pesë veta.

-Ku qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmushet, ka humbur aftësi paguese.

-Me vendim të Gykatës kur shoqata largohet nga qëllimi i caktuar me statut ose kryen veprimtari të kundërligjshme. Në rast shërndarje të shoqatës ajo pushon veprimtarinë e saj dhe vihet në likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve dhe c'rregjistrohet.

NENI 14

Ky statut hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqatës në gjykatën e Rrethit Tiranë, në këtë ditë shoqata njihet edhe si person juridik.

ANTARËT THEMELUES: Nuri Abdiu, Hajri Mandri, Musa Rriçku, Shaqir Skarra, Sali Shira.

Intervistë e Artistes së Merituar Lirie Rasha (Jushi)

Këngën po i'a lë trashëgim vajzës

Lirie Rasha (Jushi) ka lindur në Zalldardhë më 1957 në një familje me tradita kulturore. Në skenë është ngjitur në moshën 18-vjeçare me këngën "Mora rrugën mora". Nga zëri dhe interpretimi i saj dinjitoz shumë këngë të saj u bënë hite, si "Kënga e Rexhës", e plot këngë të tjera. Në vitin 1989, është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë me titullin e lartë "Artiste e Merituar" .

Tashmë, ju jeni një këngëtare e njohur, jo vetëm në Shqipëri por edhe në diasporë. Mund të na tregoni diçka mbi fillimet e tua?

Treva e Dardhës shquhet për tradita kulturore, por edhe në familjen time në Lashkizë, në dhomën e librave gjithmonë ka qenë edhe një çifteli, që jo vetëm në gëzime e dasma, por edhe në ditë të zakonshme, bëhej muzikë. Më vonë, në shkollën 8-vjeçare u aktivizova si këngëtare dhe asnjëherë nuk i jam ndarë asaj, e as ajo mua.

Kush ishin ata që zbuluan tek ju talentin e të kënduarit?

Pasioni për muzikën dhe dëshirën për këngën e kisha. Por, krahas zërit dhe punës sime për rritjen e cilësisë së interpretimit nuk mund të lë pa përmendur edhe ndikimin nga Artisti i Merituar, Haziz Ndreu, Hilmi Kolgjegja dhe Laim Kola..

Cilat janë disa nga aktivitet e tua kryesore në Shqipëri dhe Diasporë?

Aktivizimi im parësor është te Estrada e Peshkopisë, ku isha këngëtare profesioniste. Kam marrë pjesë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës në vitin 1972, 1983 dhe1988 si dhe në një Festival të Muzikës së Lehtë në RTSH. Pas viteve '90-të, kam marrë pjesë në disa koncerte në diasporë, ndërsa para viteve '90-të isha pak më e kufizuar. Në vitin 1976, me Ansamblin Shtetëror të Këngëve e Valleve kam bërë një turne në Jugosllavi, në Itali më 1977, Greqi, 1979. Me ansamblin e Shkodrës kam marrë pjesë në një kocert në Turqi më 1981. Me Ansamblin e Kukësit në Kosovë më 1982. Me Ansamblin e Shtetit në në Gjermani 1983, me ansamblin "Dibra" në Austri 1989 dhe në vitin 1990 me Ansamblin "Mirdita" në SHBA, Zvicër e Maqedoni.

Në një intervistë, para shumë vitesh keni thënë: "Kam dëshirë të ua lë trashëgim këngën fëmijëve të mi". Si ndjehet Lirie Rasha tani që vajza juaj Indriti është këngëtare?

Tanimë dëshira ime është plotësuar. Indrit Jushi, vajza ime, ka fizionominë e saj si këngëtare. Me talentin e zërin e saj ajo është një këngëtare që ka publikun e vet që e duartroket dhe ka fansat e shumtë që e ndjekin në koncerte e në ekranin e televizorit.

Një ndër këngët që publiku e klasifikon si kënga e Lirie Rashës është "Xhamadani kuq si gjaku". Tani që e këndon Indriti, cili është mendimi juaj?

"Xhamadani kuq si gjaku" është një këngë shumë e mirë. Me përpunimin dhe orkestrimin me ritme më bashkëkohore, si dhe me interpretimin e Indritit iu shtuan më shumë vlerat. Për këtë më vjen mirë. Për çdo këngëtar që këndon këngën popullore dhe i jep vlera do të më bëhej qejfi e do të gëzohesha shumë.

Me çfarë merreni aktualisht dhe cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Krahas problemeve familjare merrem edhe me muzikë. Aktivizohem në koncerte brenda dhe jashtë vendit. Po punoj për të nxjerrë edhe një album tjetër me këngë të reja.

Bisedoi: ILMI DERVISHI

Shërim të shpejtë Indrit Jushi!

Gazeta "Rruga e Arbëri" dhe Shoqata e Intelektualëve Dibranë", i uron shërim të shpejtë këngëtares së talentuar, Indrit Jushi, e cila prej disa ditësh ndodhet e shtruar në spitalin "Nënë Tereza" në kryeqytet.

Botohet "Enciklopedia e Dibrës"

Pas një pune të gjatë disa vjecare domosdo dhe të lodhshme më së fundi autori Fatos Daci arriti t'ju jap dibranëve enciklopedinë e Dibrës, një libër ky i pari i këtij lloji deri tani.

Të bësh historinë e kësaj krahine aq të dallueshme nga të tjerat, dhe për një shtrirje kohore shumë të gjatë, nuk është e lehtë.Autori Fatos Daci pas një pune të gjatë disa vjecare themi se ia ka arritur qëlimit.Dibra ishte gjoksi qendresës kombëtare shqiptare. Pushka e Dibrës në mbrojtje të tokave e të sovranitetit kombëtar është shkrehur kudo, në të katër skajet e tokave shqiptare, sa herë e ka dashur puna, kundër të gjithë ushtrive barbare e pushtuese. Pushka e Dibrës kurdoherë është dëgjuar shumë larg. Varret e dibranëve në mbrojtje të tërësisë tokësore shqiptare janë kudo: në Qafë-Prush e Kolesjan, në Vllanicë, në Shkodër, Plavë e Guci, në Durrës, në Vlorë, në Gostivar, Tetovë, Shkup, në Follorinë e Janinë, etj. Kështu ka ndodhur jo vetëm në periudhën e të madhit Skënderbe, por deri në ditët tona.

Në ngjarjet dhe në situatat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare Dibra shpesh herë ka qenë e parë e shumë herë të tjera, ndër të parat. Dibrani Iljaz Pashë Dibra, jo tjetër kush, qe kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në aktin historik të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali kishte në të dy krahët e tij nënkryetarin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës-Nikollë Kaçorri prej Lure (edhe kryetar i Katolicizmit në Shqipëri) dhe Vehbi Dibrën, kryetar të Senatit (dhe kryetar Komunitetit Mysliman Shqiptar).

Në ballë të luftëtarëve dibranë qenë prijës të tillë popullore si Mustafë Lita, Mahmut Daci, Elez Isufi, Dan Cami, Mehmet Duriçi, Aziz Xheka, Hasan Shini, Xheladin Seferi, Baftjar Doda, Hasan Kaci, Lam Daci, Elez Koçi e Haziz Lila, etj.; burra si Murat Kaloshi, Ali Maliqi, Hysni Dema, Dine bej Maqellara, Tafë Kazia, Halil Alia, Dine Hoxha; dijetar si



Ismail Strazimiri, Josif Bagëri, Hoxhë Moglica; mendarë si Salë Demiri, Salë Markja, Demir Lusha; klerikë të shquar si sheh Zumani i Vleshës, sheh Mustafa i Zerqanit, etj.

Dibranët shkuan si burrat në Kongresin e Lushnjës (1920), tue pas të parë atdhetarin Ramiz Daci. Dibranët, me "Heroin e Popullit" Ramiz Varvarica u përfaqësuan denjësisht në brigadat internacionale në Spanjë kundër diktaturës frankiste dhe luftuan për një republikë demokratike. Dibranët rrokën armët për të pritur me pushkë hordhitë pushtuese të Italisë, më 7 prill 1939 dhe i dhanë atdheut dëshmorët e parë të Luftës së Madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare : Isak Metalia e Dan Velia.

Dibra i dha LANÇ dy brigada partizane: Brigadën XVIII dhe Brigadën VII Shqiptaro-Maqedonase. Dibra i dha LANÇ-it mbi 175 dëshmorë, 6 "Heronj të Popullit" si Qemal Stafa, Haxhi Lleshi, Gjok Doçi, Nazmi Rushiti, Hibe Palikuqi dhe Liman Kaba; Dibra i dha LANÇ-it dy gjeneralë dhe dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm: Dali Ndreun e Haxhi Lleshin dhe në periudhat e mëvonshme edhe 6 gjeneralë të tjerë: Ali Koçeku, Dilaver Laçi, Gjergj Vladi, Bashkim Gazidede, Agim Shehu, Hysen Rrepa, Beqir Pregja dhe një kryegjeneral të dy luftërave unikale shqiptare në Kosovë e Maqedoni-Gëzim Ostrenin. Dibrani koxhaxhikas Mustafa Qemal Ataturku, krijoi dhe udhëhoqi Turqinë moderne.

Plot dibranë morën poste ministrore dhe parlamentare, në të dy anët e kufirit, në qeveritë e Ahmet Zogut, qeveritë e periudhës 1939-1944, të periudhës 1945-1990 dhe të pas vitit 1990. Mbi 22 dibranë kanë kryer detyrën e ministrit vetëm në Republikën e Shqipërisë dhe 8 të tjerë kanë mbajtur portofole zv.ministri. Dibra i dha vendit një kryeministër-Fiqiri Dinen. Dibra i dha Shqipërisë një kryetar të Senatit të Vlorës në 1912-Vehbi Dibrën, një kryetar të Kuvendit Popullor-Haxhi Lleshin, një zv.kryeministër-Shkëlqim Canin; Dibra u dha besimtarëve katër kryemyfti e kryetarë të Komunitetit Mysliman Shqiptar: Vehbi Dibrën, Muharrem Mullajn, Sali Feratin dhe Selim Muçën; një guvernator Banke të Shqipërisë, një kryetar të Gjykatës Kushtetuese, Fehmi Abdiu, etj.,etj.

Në fushën e dijes, arsimit e shkencës Dibra i ka dhënë vendit 18 profesorë, 10 Profesor ass. dhe 35 doktor shkencash në fusha të ndryshme; 6 "Mësues të Popullit": Millosh Gjergj Nikolla-Migjeni, Haki Sharofi, Said Najdeni, Selim Alliu, Irfan Tërshana, Nuri Abdiu; 4 dekanë fakultetesh: Isak Shehun, Kadri Zhulalin, Petrit Barën,Veli Zogun, etj.. Vetëm në shëndetësi janë 13 mjekë të shquar,me grada e tituj shkencor: Ilia Mazniku, Basri Neziri, Mira Neziri, Petrit Bara, Muhamet Kodra, Nazmi Koçi, Islam Dauti, Mehdi Cami, Ahmet Kamberi, Sulejman Zhugli, Alia Tonuzi, Rahim Gjika, Luljeta Lleshi, etj..

(Vijon në faqen 8)

Mentor Hoxha zbulon jetën private të 90-të personazhe Vip

Poeti dhe gazetari Mentor Hoxha ka hedhur në qarkullim librin e tij të katërt "Sekretet e Vip-ave". Në 275 faqet e këtij libri tepër luksoz të shoqëruar me 340 foto, kryeministri Sali Berisha dhe 90 deputetë, prezantues, mise, balerina, aktorë, këngëtarë, sportistë dhe figura të tjera mjaft të njohura, zbulojnë jetën e tyre private e profesionale. Libri ka patur një shitje record dhe është pritur mirë nga media. Gazeta "Ballkan", "Koha jonë", "Republika", "Albania", "55", "Atdheu", "Gazeta e Athinës", TV "Shijak", TV "Arbëria", e disa media të tjera kanë shkruar me superlativa të mëdha për vlerat e këtij libri dhe për talentin e gazetarit Mentor Hoxha, i vlerësuar nga gazetat e lartpërmendura si një krijues me gjetje të rralla artistike dhe si një ndër intervistuesit më të mirë në Shqipëri. Redaktorë të librit janë, Haki Manuka dhe Shaqir Skarra, kurse recensues Ilmi Dervishi. Mentor Hoxha shquhet në këtë gjini letrare pasi ka një përvojë të gjatë në shtypin qendror si gazetar në "Koha Jonë", "SOT", "Mërgimtari Shqiptar" dhe revista "Blic". Është kryeredaktor tek revista "Vajza e Ditës" dhe "Personazhe VIP". Ka botuar librat "Sekretet Miss-eve", "Shpërthimet e Zemrës" dhe "Sekretet e Vip-ave". Gjithashtu ka publikuar në shtypin qendror 780 intervista dhe 8300 artikuj politikë, analitikë dhe informativ. Për kontributin e dhënë në median e shkruar është përfshirë në librin "Gazetarë dhe Publicistë Shqiptar", botim i vitit 2005", si dhe në librin "Enciklopedia e Dibrës".

(Vijon në faqen 8)

Zbulohen varret e betejës së Sfetigradit



Kalaja e Koxhaxhikut. Foto: Gazmend Kërkuti

Sfetigradi një nga përplasjet më të mëdha të Skëndërbeut me turqit. Dhe ja tani pas 558 vjetësh realizohet një zbulim i jashtzakonshëm. Pikërisht në fshatin e njohur Koxhaxhik të Dibrës zbulohen varret e viktimave të betejës së famshme të Sfetigradit ku heroi ynë kombëtar Skëndërbeu pësoi dhe humbjen e parë.Kanë qenë një grup specialistësh dibranë që ditët e fundit kanë ndërmarrë një ekspeditë të thjeshtë por që nga rëndësia mund të quhet pa frikë një punë e jashtzakonshme. Këtu bëhet fjalë për dy masive varresh të vendosura në të dyja anët e pllajës ku ishin të vendosura varret e viktimave të luftës së Skëndërbeut me Sulltan Muratin II.Është folur shumë për këtë betejë të heroit tonë por asnjëherë nuk është lokalizuar vend ndodhja e saktë e saj.Dhe ja kur kanë kaluar me shumë se pesë shekuj e gjysmë e vjen zbulimi i madh që më tepër se kujtdo i shërben historianëve. Pikërisht në afërsi të fshatit Koxhaxhik ku ende sot banohet me nje etnitet turqish, janë zbuluar varret e atyre që ranë në betejë.Ky zbulim pritet të shoqërohet më shumë me studime të historianëve për të sjellë fakte të reja që historisë i kanë munguar. Në fillim ekspedita u nis pa shumë pretendime por tashmë zbulimi ka një vlerë të jashtëzakonshme historike. Një grup specialistësh janë nisur në vendin ku më shumë se pesë shekuj më parë është zhvilluar beteja e Skëndërbeut dhe pikërisht këtu kanë zbuluar dy masivet e varreve.Sipas burimeve po nga këto specialist që kanë marrë pjesë në këtë ekspeditë bëhet fjalë për rreth 1200 varre, që mendohet se janë të ushtarëve të Skëndërbeut dhe më shumë nga pala turke.Ato janë vendosur në një pllajë dhe janë të ndarë në muslimanë dhe katolik.Sipas specialistëve, kjo nënkupton se të parët janë turq dhe të dytët janë ushtarët e Skëndërbeut.Deri më sot nuk ka folur prerë për vendndodhjen e kësaj beteje.Kjo ekspeditë ka hedhur dritë njëherë dhe mirë mbi vërtetësinë e betejës së Sfetigradit të vitit 1448. Nga këto varre të zbuluara mendohet se 900 janë muslimanë turq dhe 300 katolik, ushtar të Skëndërbeut. Lidhur me këtë zbulim kanë reaguar menjëherë dhe historianët tanë të cilët i japin një rëndësi të vecantë këtij zbulimi.Nëse vërtet vertetohet se këto varre I përkasin asaj periudhe do të bëhej një përmbysje se ky vend ndodhej në Sopotnicë një fshat ky po në Dibër.

Për historianët tanë të periudhës së mesjetës Petrika Thëngjilli dhe Kasem Bicoku të cilët kanë dhënë mendimin se kështjella e Sfetigradit mund të lokalizohet në Sopotnicë, zbulimi i fundit është një e re që duhet marrë në konsideratë.

Janë jo të pakta kështjellat që kanë hyrë në histori në periudhën e Skëndërbeut, e njëra prej tyre është dhe kështjella shekullore e Sfetigradit. Emri i kështjellës së Sfetigradit është bërë i njohur në kohën e heroit tonë kombëtar prej ngjarjeve heroike dhe dramatike. Emri i Sfetigradit përmendet në dokumentat e kohës së Skëndërbeut, në kronikat e autorëve bizntinë, në veprat e historianëve të vjetër osmanë, mbi të gjitha në historinë e Marin Barletit. Kronisti bizanti Laonik Halkokondili flet mjaft për këtë kështjellë dhe e përmend me emrin Sfeti.Kurse Marin Barleti dhe mjaft dokumenta të kohës e kanë emëruar Sfetigrad që sllavisht do të thotë qytet i shenjtë emër ky që lidhet me manastiret dhe kishat e shumta sllave që ishin në rrethinat e tij.


Disa historianë sllavë janë shprehur se Sfetigradi nuk është në Koxhaxhik. Për vendndodhjen ato kanë dy qëndrime.Njëri lokalizon Sfetigradin me fshatin Rahovik (qyteti i Dibrës sot) dhe qëndrimi tjetër e lokalizojnë me Malin e shenjtë në Mirditë.Këto dy varinate nuk mbështeten nga burime historike pasi nuk ka patur kështjella në kohën e Skëndërbeut as në Rahovik dhe as në Malin e shenjtë.Për sa i takon lokalizimit me Koxhaxhikun kjo është më afër të vërtetës.Bazë shkencore ka zbulimin e masiveve të varrezave që u gjetën ditët e fundit. Vetë Koxhaxhiku e ka marrë emrin nga turqishtja që do të thotë betejë e madhe.Megjithatë historianët tashmë kanë një burim të sigurtë.


Rruga Milot-Peshkopi, rruga e ferrit

Ekziston një rrugë nacionale që lidh Dibrën me Tiranën gjithsejt 183 km. Rruga është ndërtuar fill pas clirimit.Pikërisht nëpër trasenë e kësaj rruge është shfrytëzuar jo vetëm miniera e Bulqizes por dhe ajo e Batrës,Thekrës si dhe mermeri aq i njohur i Muhurrit.Sot rruga ndodhet në një gjendje krejt ndryshe.Dhe kjo duhet pranuar si një realitet që po e shikojmë shpesh,e më shumë këto pasoja po i paguan biznesi jo vetëm ai dibranë por dhe më gjërë. Nga Tirana deri në Milot rruga është e rregulluar.Kjo falë autostradës së re që lidh Shkodrën me Tiranën.Nga Miloti për në Peshkopi ajo cdo gjë mund të jetë por vetëm rrugë nacionale nuk mund të quhet por si një rrugë rurale që shërben për të bashkuar fshatra bashkë..Dalin cdo ditë makina të tonazheve të rënda nga dogana e Bllatës të cilat nisin udhëtimin drejt Tiranës dhe qyteteve të ndryshme të vendit.Sapo makina kalon traun e doganës shoferi dhe shoqëruesi i mallit do të ndeshet më dicka të pazakontë (kjo ndodh për ato automjete që futen për herë të parë).Asfalti edhe në afërsi të doganës së Bllatës ka dalë dhe gropat në rrugë të tmerrojnë.Kjo nuk është vetëm në Bllatë.E njëjta gjëndje e kësaj rruge është deri në Milot, një distancë kjo jo pak e vogël. I janë trembur kaq shumë kësaj rruge biznesmenët saqë me të drejtë vitet e fundit shoferët e kanë quajtur “rruga e ferrit”Jo vetëm këto por dhe pasagjerët që udhëtojnë për në Peshkopi e kanë siklet të madh udhëtimin por koston e madhe të dëmit e paguajnë biznesmenët dhe shoferët. Shpenzime karburanti, goma, riparime të shpeshta mjeti, orë të gjata udhëtimi.Nuk I thonë pak të udhëtosh gjashtë por dhe shtatë orë udhëtim në një rrugë tërësisht të shkatruar sikur ka dalë nga lufta.Është pra një kosto e madhe në humbje dhe shteti as që do t’i a dijë.Biznesi paguan për rrugën, taksën e mallit që ka ngarkuar dhe paguan më shumë burokracinë dhe neglizhencën e shtetit të tij.Mund të themi me bindje se është e vetmja rrugë në vendin tonë në këtë gjendje dhe kjo është dicka si duket me sy.Nëpër këtë rrugë udhëtojnë njerëz të sëmurë që shkojnë për kurim në spital apo dhe qytetar të ndryshëm, turist dhe tregtar, pushtetar dhe delegacione të huaja.Flitet si nën zë se qeveria ka akorduar një fond për rregullimin dhe rehabilitimin totalisht të këtij segmenti aq të shkatruar.Ne si gazetë nuk mundëm të kontatojmë me njeri dhe të kemi një informacion të sakt rreth këtij fondi, megjithatë le të presim.Fundja shqiptarët janë mësuar me pritje të gjata.




Botime të autorëve dibranë











Promovohet libri poetik "Zjarret e ditëverës"




Më datën 12.05.2006 ora 18 në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve u bë promovimi i librit me poezi "Zjarret e ditëveres me autor zotin Hajri Mandrri. Promovimi u bë nga shoqata "Lidhja e intelektualëve dibranë" Të pranishëm në sallë kishte poet e shkrimtar, artist, intelektual të fushave të ndryshme.I pranishëm ishte dhe shkrimtari i njohur Teodor Laco si dhe Agron Tufa. -Ndjehem disi ndryshe, tha në fjalën përshëndetëse shkrimtari Teodor Laco kur rri në një sallë mes intelektualëve dibranë. Dibranët janë intelektual nga natyra.Poeti Hajri Mandrri është njëkohësisht dhe miku im i hershëm por në këtë sallë unë njohë dhe plot të tjerë.Rreth librit foli shkrimtari njëkohësisht dhe redaktori i këtij libri Agron Tufa.Në fjalën e tij shkrimtari Agron Tufa u shpreh:-Hajriu me këtë vëllim me poezi është munduar të bëhet sa më i besueshëm përballë lexuesit dhe them se ia ka arritur qëllimit.Shumë nxënës shkollash recituan poezi nga vëllimi poetik.Ky ishte aktiviteti i parë i këtij lloji i shoqatës "Lidhja e intelektualëve dibranë"

Botohet "Enciklopedia e Dibrës"

(Vijon nga faqja 1)

Në fushën e studimeve ushtarake janë 3 dr.shkencash-Hasan Çipuri, Agim Shehu, Hasan Leka; Dibra ka 24 "Heronj të Punës" dhe 4 "Mjeshtra të Mëdhenj": Hazis Ndreu, Telat Agolli, Drita Agolli, Sulejman Pitarka,etj ; një "Laurat të Çmimit të Republikës" në fushën e veprave bonifikuese e vaditëse-Beqir Kalia; një "Arist të Popullit"-Telat Agolli, 1 "Piktor të Popullit" –Nexhmedin Zajmi, tre "Artist të Merituar": Agim Krajka, Haziz Ndreu e Liri Rasha; 15 këngëtarë e këngëtare me zë, mbi 60 shkrimtarë e poetë në ballë të cilëve janë Migjeni (me baba nga Reka) dhe Haki Stërmilli; një "Piktor të Popullit'-Nexhmedin Zajmi dhe një "Piktor të Merituar" -Bajram Mata; një Miss Albania dhe një "Miss Dituria" e Botës-Denisa Kola; një Kampion Olimpik në peshëngritje-Ymer Pampuri, një Kampion Bote në hedhje shtize-Mirela Manjani; 5 sportistë "Nderi i Sportit Shqiptar": Xhelil Cibaku, Fiqiri Rama, Taxhedin Shehu, etj.; 8 "Mjeshtra të Merituar të Sportit"; 50 "Mjeshtra Sporti", 15 Kandidatmjeshtra Sporti, 225 kampionë në lloje të ndryshme sporti (vetëm në mundje janë shpallur 100 kampionë kombëtarë; 47 sportistë pjesëmarrës në veprimtari sportive ndërkombëtare; mbi 20 gazetarë profesionistë këtej e andej kufirit, etj.etj.

E çfarë mund të jepte më shumë Dibra në luftë, në punë dhe shkencë, art e kulturë!



Sidoqoftë, le të pajtohemi me mendimin se dha pak, për të patur dëshirën e mëtutjeshme që t'i japim atdheut dhe kombit tonë sa më shumë dije, djersë, shkencë, art, kulturë dhe, kur të lypset, pse jo, edhe gjak! Jeta, lufta dhe vepra e tyre e nderuar le të mbeten krenaria dhe obligimi ynë! Të gjitha këto lexuesi tashmë do t'I gjejë në librin e sapo dalë nga botimi "Enciklopedia e Dibrës" me autor zotin Fatos Daci.Themi me bindje se autori I ka bërë një shërbim të madh Dibrës dhe dibranëve me këtë botim që na dha në dorë.

Mentor Hoxha zbulon jetën private të 90-të personazhe Vip

(Vijon nga faqja 1)

Është diplomuar për gjuhë-letërsi dhe ka mbaruar disa kurse pasuniversitare në Angli.

Në librin e tij "Sekretet e Vip-ave" janë përfshirë, Sali Berisha, Dritëro Agolli, Jozefina Topalli, Alfred Moisiu, Bamir Topi, Miss Globe 2004, Rubena Moisiu, Majlinda Bregu, Besnik Mustafaj, Mimi Kodheli, Paskal Milo, Sabri Godo, Valentina Leskaj, Fatmir Mediu, Teodor Laço, Arta Dade, Arjan Starova, Sadri Abazi, Petraq Kolevica, Sonila Laci, Rudina Magjistari, Ardian Sërbu, Inis Gjoni, Artemisa Ozaj, Leonard Bombaj, Anjeza Maja, Ëejda El Sayed, Ermiona Lekbello, Amanda Pëllumbi, Lili Cingu, Rexhep Çeliku, Enada Hoxha, Manjola



Hasani, Xhemi Shehu, Flora Gargano, Elinda Sulejmani, Ilir Shaqiri, Anita Take, Bujar Qamili, Manjola Nallbani, Silvana Dollapi, Albërie Hadërgjonaj, Bleona Qerreti, Rovena Dilo, Kastriot Tusha, Eli Fara, Irini Qirjako, Mariza Ikonomi, Evis Mula, Ingrid Gjoni, Medi Prodani, Rozana Radi, Elisabeta Marku, Edona Llalloshi, Sinan Hoxha, Mira Bregu, Rovena Stefa, Artiola Toska, Sabiani, Anxhela Peristeri, Elinda Pepnika, Behar Mera, Rita Lati, Cekja, Stefan Prifti, Fiqiri Rama, Njazi Ruka, Met Bega, Muharrem Hoxha, Timo Flloko, Serafin Fanku, Gëzim Kame, Vasjan Lami, Rozina Prendi, Alban Skënderaj, Ela Tase, Zhani Ciko, Simona Neagu, Pompeiu Harasteanu, Eranda Topi, Dea Rriçku, Avni Elezi, Viron Kona, Genta Ismaili, Adelina Ismaili, Ermela Teli dhe Enkelejda Bargjo.

Botime të autorëve dibranë



